



FTESË

PËR INFORMIM LIDHJE ME QËLLIMIN DHE FUSHËVEPRIMIN E PROJEKTIT

Organizata “Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës” (IADK) është duke zbatuar projektin “**Krijimi i vendeve të punës në bujqësi**” projekt 18 muajsh (Gusht 2020 – Janar 2022). Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian përmes programit IPA të bashkëpunimit ndërkuftar në mes Malit të Zi dhe Kosovës. Aktivitetet e projektit në pjesën e Malit të Zi do të zbatohen nga Kryeqyteti i Podgoricës, kurse në pjesën e Kosovës (Pejë dhe Istog), zbatuese e aktiviteteve të projektit është IADK.

Qëllimi specifik i projektit është krijimi i vendeve të punës në bujqësi përmes ofrimit të mundësive për punë praktike dhe shpërndarjes së granteve për kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike.

Me qëllim të promovimit dhe ofrimit të informacioneve në lidhje me objektivin dhe fushëveprimin e projektit, IADK ka paraparë mbajtjen e sesioneve informuese në komunën e Pejës dhe Istogut.

Mirëpo, marrë parasysh kushtet e krijuara nga pandemia COVID-19 dhe rregullave të publikuara nga IKSHPK për parandalim të përhapjes së virusit, IADK do të organizojë sesion informues përmes platformës digjitale ZOOM, me datë 11.11.2020 nga ora 10.00, ku ndjekësit do të kenë mundësinë të marrin informata për qëllimin e projektit, aktivitetet e projektit, grantet përkrahëse dhe mundësitë e aplikimit.

Për qasje në sesion informues ju mund të klikoni mbi këtë link: <https://us02web.zoom.us/j/84382497473> apo mund të kyqeni edhe përmes numri identifikues të sesionit: 843 8249 7473.

Për informata më të hollësishme në lidhje me projektin dhe qasjes në sesion informues mund të na kontaktoni edhe përmes adresës elektronike: sylejman.bunjaku@iadc.org, behare.mlinaku@iadc.org, iadc@info.org, apo përmes numrave të telefonit: **049 904 918 dhe 044 412 475**.

Për të interesuarit të cilët nuk kanë mundësi të kyqen në sesionin informues përmes platformës digjitale ZOOM, stafi i projektit do të organizojë edhe takime me grupe të vogla sipas udhëzimeve të IKSHPK-së / tryeza informuese në zyrat e bujqësisë në komunat përkatëse, ku të interesuarit mund të njoftohen më hollësisht lidhje me projektin.

Të dhënat e tryezave informuese		
Data	Ora	Komuna
13.11.2020	10:00-12:00	Pejë
13.11.2020	13:00-15:00	Istog
16.11.2020	10:00-12:00	Pejë
16.11.2020	13:00-15:00	Istog

Sinqerisht

Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv



Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian



MNE - KOS

PROGRAMI IPA I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020